Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:[**shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE**], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne [**vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit**, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti], nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [**vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit**].
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor** [**vendos emrin e Autoritetit Kontraktor**], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për [**vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE**] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sçarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllongarit çmimin bazuar në:

- a) *çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;*
- b) *elementet fiskale;*
- c) *normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;*

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	Bashkuese te shpejta tub ajri plastike d=14mm per 12 bar	Copë	12
2	Rakorderi tubo gome presion 270bar per Φ 3/8"(mashkull-femer)	Sete	30
3	Rakorderi tubo gome presion 270bar per Φ 1/2"(mashkull-femer)	Sete	20
4	Rakorderi tubo gome presion 270bar per Φ 3/4"(mashkull-femer)	Sete	20
5	Rakorderi tubo gome presion 270bar per Φ 5/8"(mashkull-femer)	Sete	30
6	Rakorderi tubo gome presion 270bar per Φ 1"(mashkull-femer)	Sete	10
7	Aparat zmerilues për stuko (me ajer)	Copë	4
8	Aparat lucidimi boje	Copë	1
9	Trapan	Copë	2
10	Aparat gurë freksibël	Copë	2
11	Pistoletë për lyerje	Copë	1
12	Tub presioni me 4 shtresa	Copë	120
13	Tubo gome presion 270bar per Φ 3/8"	Metër	70
14	Tubo gome presion 270bar per Φ 1/2"	Metër	30
15	Tubo gome presion 270bar per Φ 3/4"	Metër	20

16	Tubo gome presion 270bar per Φ 5/8"	Metër	70
17	Tubo gome presion 270bar per Φ 1"	Metër	15
18	Disk sharre me dhembe diamanti prerje asfalt dhe beton d=400mm	Copë	40
19	Kuti kriketa 2/4	Sete	1
20	Kuti kriketa 3/4	Sete	1
21	Set kacavidash	Sete	1
22	Tub ajeri per kompresor gome	Meter	10
23	Pistolet per lirim dagicekesh	Copë	1
24	Celes filter, vaj	Copë	1
25	Set celsa fiso-poligon	Sete	1
26	Set celsa fiso	Sete	1
27	Set celsa poligon	Sete	1
28	Aparat karikimi bateri starter	Copë	1
29	Aparat mates per bateri	Copë	1
30	Monometer mates ajeri kompresori	Copë	1
31	Pompe lavazhi	Copë	1
32	Stek lavazhi	Copë	1
33	Seri celsa egzagpnel	Sete	1
34	Seri celsash ylleza	Sete	1
35	Gjenerator pompe thithese-sharre prerese	Copë	2
36	Sharra per prerje asfalti	Copë	2
37	Balanteza 50m 2.5 trashesia	Copë	2
38	Makineri aparak k/k me ngjitje deri ne 450	Copë	1
39	Celes fiso poligon Φ 17-19	Copë	3
40	Celes fiso poligon Φ 22-24	Copë	3
41	Celes fiso poligon Φ 24-27	Copë	3
42	Celes fiso poligon Φ 27-32	Copë	3
43	Celes fiso poligon Φ 30-32	Copë	3
44	Celes fiso poligon Φ 34-34	Copë	3
45	Celes fiso poligon Φ 36-36	Copë	3
46	Celes 42	Copë	3
47	Celes 56	Copë	3
48	Celes 60	Copë	3
49	Celes anglez 36	Copë	3
50	Celes anglez 42	Copë	3
51	Celes papagall Φ 12	Copë	3
52	Celes papagall Φ 14	Copë	3
53	Celes papagall Φ 18	Copë	3
54	Celes papagall Φ 24	Copë	3
55	Kzem+bisht	Copë	50

56	Lopata+bisht	Copë	50
57	Bisht	Copë	50
58	Preres Tubash	Copë	1
59	Sharre hekuri	Copë	3
60	Varre	Copë	10
61	Cekic gome	Copë	101
62	Leva	Copë	10
63	Fshese me bisht me furce metalike	Copë	2
64	Meter	Copë	1
65	Sharre per prerje tubash	Copë	1
66	Shkalle profesionale (10m)	Copë	1
67	Makineri per ngritje tubash koke/koe	Copë	1
68	Kuzhineta 6319 SKF	Copë	5
69	Pastrues per tub HDPE para ngritjes (mekanik) (scraper) per tuba 180-400	Copë	1
70	Detektor per humbjet	Copë	1
71	Çengela per hapjen e kapakeve te pusetave	Copë	20
72	Trapan	Copë	2
73	Gjenerator I vogel	Copë	1
74	Karrocc dore+gome	Copë	10
75	Gome per karroca dore	Copë	15
76	Pincet per prerje tubash	Copë	5
77	Sharre druri	Copë	3
78	Çekiç hekuri I vogel	Copë	5
79	Dalte	Copë	6
80	Syze mbrojtese	Copë	3
81	Litar sigurie Maske kundragazi me ndricim	Copë	5
82	Maske kundragazi me ndricim	Copë	5
83	Ndricues Led te vogla	Copë	5

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientësi dhe energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike

1 Bashkuese te shpejta tub ajri plastike d=14mm per 12 bar

Bashkueset e ajrit duhet te jene te pershtatshme per tub ajri plastik me diameter 14mm dhe presion minimalisht 12 bar.

2-6 Rakorderi tubo gome me presion 270 bar.

Rakorderit te jene sipas permasave te kerkuara ne preventiv dhe te pershtatshme per tubo me shtresa per te perballuar presion minimalisht 270 bar.

7 Aparat zmerilues për stuko (me ajer)

Aparati duhet te kete siperfaqe zmeriluese te pakten 5.5" dhe te arrije deri ne minimalisht 10000 rpm. Me hyrje ajri ¼" dhe presion minimal 6 bar.

8 Aparat lucidimi boje

Aparati I lucidimit te kete shpejtesi rrotullimi te pakten 2000rpm dhe fuqi jo me te madhe se 1250W. Fuqia ne hyrje 220V dhe frekuenca 50hz.

9 Trapan

Trapani te jete I pajisur me bateri 4000 Mah me karikim te shpejte. Dorezat e trapanit te jene te veshura me gomina. Te mund te cpoje te pakten deri ne 25mm dhe te arrije jo me pak se 4700 rpm.

10 Aparat gurë freksibël

Guri fresibel te jete I pajisur me bateri 3000MaH te rikarikueshme me karikim te shpejte. Diametri I diskut jo me I vogel se 110mm.

11 Pistoletë për lyerje

Presioni i punes se pistoletes jo me i vogel se 3 bar dhe te harxhoje maksimalisht 6.5cfm. Stili I lyerjes te mund te mbuloje te pakten 165mm me nje gryke 1.5 mm.

19 Kuti kriketa 2/4

Kuti me 10 koka kriketi ½.

20 Kuti kriketa ¾

Kuti me 21 koka kriketi ¾" me material krom vanadium.

21 Set kacavidash

Set me 7 kacavida + -me gjatesi te ndryshme.

23 Pistolet per lirim dadicekesh

Pistoleta te jete e pajisur me bateri 2000mah me fuqi minimalisht 260N.m. PErmasat e kokes te jene ½ dhe te arrije jo me pak se 2500rpm.

25 Set celsa fiso-poligon

Set celsash fiso poligon ,12 celsa me permasa nga 8mm deri ne 24mm me material krom vanadium.

26 Set celsa fiso

Set me Celsa fiso 8-19mm.

27 Set celsa polygon

Set me 9 celsa poligon me permasa nga 6-24mm me material kromvanadium.

28 Aparat karikimi bateri starter

Karikuesi I baterive te mund te prodhoje deri ne 24v ne dalje dhe te mund te karikojë bateri deri ne 400AH. Te mund te karikojë deri ne rryma 45A.

29 Aparat mates per bateri

Matesi I baterive duhet te kete nje ekran lcd ku te shfaq te dhenat e matjes. Te arrije te lexoje rryma AC dhe rryma DC deri ne 550V.

31 Pompe lavazhi

Pompa e lavazhit te kete fuqi jo me te madhe se 1400W. Presioni maksimal I dergimit te ujit te pakten 1500 psi.

35 Gjenerator pompe thithese

Gjenerator I pershtatshem per tension220V me fuqi maksimale minimalisht 2.7kw. Te jete I paisur me motor me 4 kohe dheme ftohje me ajer. Kapaciteti I depozites te karburantit minimalisht 15liter. Pesha neto maksimumi 50kg.

36 Sharra per prerje asfalti

Sharra te jete per prerjen e asfaltit, me motor benzine per autonomi ne perdorim. Te jete e pajisur me bosht per mbajtjen e drejtimit dhe me doreze te rregjistrueshme. Thellesia e prerjes te jete e ndryshueshme ne pozicionin e deshruar ku maksimumi I thellesise mos te jete me I vogel se 14cm. Sharra te kete vibrim te ulet ne perdorim per te mos demtuar operatorin. Vibrimi maksimal ne doreze te jete jo me shumse se 6m/s² . Sharra te jete me sistem uji per ftohjen e

disukut si dhe per te ulur nivelin e pluhrave gjat prerjes. Depozita e ujit prej te pakten 30liter, te jete e cmontueshme pa nevojën e veglave ndihmese ne menyre qe ti behet sherbim ne cdo kohe. Sharra te jete e pershtatshme per tu perdorur me disk 400mm, dhe nr rrotullimeve te mos jete me pak se 2000rpm. Motorr kater kohesh me konsum jo me shume se 3,1 liter/ore dhe me fuqi pune jo me pak se 6KW. Motorr te jete i pajisur me nje ose me shume cilindra me kapacitet jo me shume se 280cm³ dhe shpejtesi pune 3600 1/min. Te mund te punoje ne temperature jo me te vogla se -15°C dhe minimalisht deri ne 36°C. Lartesia e pajisjes se montuar jo me e madhe se 40”, gjeresia jo me shume se 24” dhe gjatesi jo me te vogel se 35”.

38 Makineri Aparat k/k me ngjitje deri ne 450

Makineria per ngjitje tubosh koke me koke te jete e pershtatshme per ngjitjen e tubave me diameter minimalisht 180-450mm. Makineria te jete e pershtatshme per ngjitjen e tubave te polipropilenit dhe polietilenit. Te jete e pershtatshme per ngjitje tubash me presion minimalisht 32Bar. Makineria te jete e pershtatshme per perdorim automatik dhe manual dhe te ofroje mundesine per rregjitrinin e emrit te projektit per ngjitjen e kryer. Te ofroje mundesine per kontrollin ne ekran te te pakten 25 ngjitjeve te fundit si dhe mundesine per ruajtjen e grafikeve ne USB. Te jete e pajisur me termometer dhe barometer per matjen e temperatures dhe presionit te ambientit.

Aparati per ngjitjen e tubave duhet te jete i perbere nga pjeset si ne vijim:

- Makineria bashkuese, e cila duhet te jete e perbere nga te pakten dy cilindra me presion maksimal te pakten 130bar dhe me seksion terthor te pakten 14cm², ne te cilet te montohen kapeset e tubit te cilat duhet te jene me diameter te pakten 450mm. Njera ane e makinerise te jete e levizshme dhe tjetra statike.
- Makineria hidraulike, e cila duhet te jete automatike, te jete e pajisur me manometer, rregullator presioni dhe tregues niveli vaji.
- Makineria prerese, e cila duhet te jete e perbere nga dy thika ne secilen ane te saj, qe bejne te mundur prerjen e tubove ne menyre te tille qe te puthiten nemenyre perfekte. Makineria te jete e pajisur me nje motorr me fuqi te pakten 1kw dhe me system sigurie qe makineria prerese te mosshkeputet nga makineria bashkuese kur motorri eshte duke punuar.
- Makineria ngrohese, me fuqi te pakten 5kW, e cila duhet te jete e pajisur me termometer dhe me termostat ne menyre qe te beje nje nxehje sa me te mire dhe uniform te tubove.

39 Çelës fiso poligonØ 17-19

Celesa fiso poligon per dado 17 dhe 19mm. Materjali Krom vanadium.

40 Çelës fiso poligonØ 22-24

Celesa fiso poligon per dado 22 dhe 24mm. Materjali Krom vanadium.

41 Çelës fiso poligonØ 24-27

Celesa fiso poligon per dado 24 dhe 27mm. Materjali Krom vanadium.

42 Çelës fiso poligonØ27-32

Celesa fiso poligon per dado 27 dhe 32mm. Materjali Krom vanadium.

43 Çelës fiso poligonØ30-32

Celesa fiso poligon per dado 30 dhe 32mm. Materjali Krom vanadium.

44 Çelës fiso poligonØ34-34

Celesa fiso poligon per dado 34mm. Materjali Krom vanadium.

45 Çelës fiso poligonØ36-36

Celesa fiso poligon per dado 36mm. Materjali Krom vanadium.

46 Çeles 42

Celesa fiso me goditje per dado 42mm. Materjali Krom vanadium.

47 Çeles 56

Celesa fiso me goditje per dado 56mm. Materjali Krom vanadium.

48 Çeles 60

Celesa fiso me goditje per dado 60mm. Materjali Krom vanadium.

49 Çeles anglez 36

Celes anglez me hapje maksimale te pakten 36mm te prodhuar nga celik special dhe te kromuar.

50 Çeles anglez 42

Celes anglez me hapje maksimale te pakten 42mm te prodhuar nga celik special dhe te kromuar.

51 Çelës Papagall Ø12

Celes papagall me hapje te dhembeve minimalisht 42mm, permasa 12". Dhembet te jene celik CrMo, dhe doreza materjal gome per te mos rreshkitur.

52 Çelës Papagall Ø14

Celes papagall me hapje te dhembeve minimalisht 50mm, permasa 14". Dhembet te jene celik CrMo, dhe doreza materjal gome per te mos rreshkitur.

53 Çelës Papagall Ø18

Celes papagall me hapje te dhembeve minimalisht 60mm, permasa 18". Dhembet te jene celik CrMo, dhe doreza materjal gome per te mos rreshkitur.

54 Çelës Papagall Ø24

Celes papagall me hapje te dhembeve minimalisht 75mm, permasa 24". Dhembet te jene celik CrMo, dhe doreza materjal gome per te mos rreshkitur.

55 Kazëm + bisht

Kazem celiku me bisht, pesha minimalisht 1.5kg

56 Lopata + bisht

Lopate celiku e e lyster me boje puder per nje jetegjatesi sa me te larte. Gjatesia minimalisht 1.5m.

57 Bisht

Bisht druri I pershtatshem per lopata.

58 Prerës tubash

Preresi i tubave duhet te jete me trup alumini dhe teh mangani. Te jete i pershtatshem per prerje tubosh me diameter deri ne minimalisht 40mm.

59 Sharrë Hekuri

Sharra duhet te kete doreze te mbuluar me plastike dhe nje lame. Jo me e madhe se 0.18 m dhe te jete e pershtatshme per prerje te celiqeve te ndryshme.

60 Varre

Varre me koke celiku dhe e trajtuar me te nxehte dhe doreze me fibra xhami. Pesha minimalisht 2.5kg. Gjatesia e bishtit minimalisht 750mm.

61 Çekiç gome

Cekic me koke gome dhe bisht me fibra xhami. Pesha minimalisht 400g.

62 Leva

Leva te kete perberje hekuri special dhe permasa jo me te medha se 80x20 cm

63 Fshesë me bisht me furce metalike

Fshese me bisht per fshirje rruge.

64 Meter

Metri te kete kase me nderthurje plastike dhe gome per nje perdorim sa me te rehatshem. Te ofroje opsion bllokimi automatik dhe te jete me saktesi te pakten sipas klasit II. Gjatesia e matjes te pakten 5m.

65 Sharre per prerje tubash

Sharra te jete e pershtatshme perprerjen e tubove plastike, me te pakten 70 dhembe per inch. Doreza te jete plastike me dy komponente per perdorim sa me te rehatshem. Te shoqerohet me kllefin per mbulimin e tehut.

66 Shkalle profesionale (10 m)

Shkalle profesionale me gjatesi minimalisht 10m dhe te pershtatshme per mbaitje peshe minimalisht 150kg.

67 Makineri per ngjitje tubash koke/koke

Makinerai te jete e pershtatshme per saldimin e te gjitha rakorderive elektrofuzive me diameter deri ne 1150mm, me voltazh pune nga 10 deri ne 48V. Te mund te mase parametrat elektrik gjate punes me tolerance jo me shume se 1.5%. Makineria te jete e pajisur me limitues elektronik I cili ndalon punen ne rryma me te medha se 120A. Fuqia nominale e makinerise jo me e madhe se 3.6KW. Makineria duhet te jete e pajisur me skanues barcodi per te mare te dhenat e saldimit nepermjet barkodit te rakorderise per lehtësi ne pune dhe te kete mundesi te transferimit me USB te ketyre te dhenave ne makineri te tjera ngjitje .Gjatesia e pajisjes jo me e madhe se 315mm, lartesi deri ne 345mm, gjeresi deri ne 178mm dhe peshe jo me te madhe se 30 kg.

69 Pastrues per tub HDPE para ngjitjes (mekanik)(scraper) per tuba 180-400mm

Pastruesi i tubave te jete i pershtatshem per pastrimin e tubave me diameter 180-400mm. te beje te mundur fiksimin brenda tubit me morseta dhe me ane te jene doreze te rrotullohet ne pjesen e jashtme te tubit per te bere pastrimin e tij. Ne menyre qe te kete nje perdorim sa me te lehte, pesha te mos jete me e madhe se 7kg.

70 Detektor per humbjet

Detektori duhet te lokalizojë rrjetet nentokesore me ane te valeve elektromagnetike . Paisja detektuese duhet te llogarise sakte vendin ku ndodhet rrjeti , thellesia , pozicioni kendor ku eshte i lokalizuar. Paisja detektuese duhet te jete jo komplekse ne perdorim dhe me peshe te lehte nuk duhet ti kaloje 3 kg. Gjithashtu paisja duhet te jete e paisur me monitor LCD per te vizualizuar vendin ku ndodhet rrjeti I lokalizuar si dhe portat e komunikim Wireless, GPS, Bluetooth .

Dimensionet mm

Gjatesia 285

Gjeresia 109

Lartesia 790

Pesha 1.5 kg pa bateri

Konsumi I fuqise 2.25 W

Bateria 1.5 V alkaline te rikarikueshme

Ekрани

Rezolucioni 240 x 160 pixel

Permasa ekranit 45mm x 65 mm

Kontrasti 700:1

Ndricimi 500 Cd/m²

USB

Kablli Mini-B, 1.8 m

Tipi 2.0

SD Card Micro 16 GB

Bluetooth

Tipi Klasi 1

Transmetimi 19 dBm

Ndjeshmeria -92 dBm

Diapazoni operativ 1000 m

GPS

Procesor GSD4e

Precizioni < 2.5 m

Gjurmimi -163 dBm

Produkti duhet te kete manualin e instalimit, manualin e perdorimit dhe mirmbajtjes si dhe garancine nga prodhuesi 1-2 vjecare per pjeset e kembimit origjinale te detektorit te rrjeteve.

71 Cengela per hapjen e kapakeve te pusetave

Cengelat te jene materjal celiku dhe te pershtatshem per hapjen e pusetave.

72 Trapan

Trapani te jete me fuqi minimalisht 1000W dhe me thellesi shpimi te pakten 12mm. Te kete opsion per ndryshimin e xhirove te motorrit si, funksion per shpim me goditje si dhe celes per punimin ne kahun orar dhe kunderor.

73 Gjenerator i vogel

Gjenerator I pershtatshem per tension 220V me fuqi maksimale minimalisht 2.7kw. Te jete I paisur me motor me 4 kohe dheme ftohje me ajer. Kapaciteti I depozites te karburantit minimalisht 15liter. Pesha neto maksimumi 50kg.

74 Karroc dore + gome

Karroce dore me kapacitet te pakten 60 liter dhe peshembaitje te pakten 120kg. karroca te jete me doreza gome dhe rrote me me ajer me diameter minimalisht 15". Kazanite jete I prodhuar nga llamarineme trashesi te pakten 0.8mm.

75 Gome per karroca dore

Gome karroce dore e pershtatshme per mbaitje peshe 120kg, goma te jete me ajer dhe me diameter te pakten 15".

76 Pincet per preje tubash

Pinceta perprerjen e tubave duhet te jete me trup alumini dhe teh mangani. Te jete I pershtatshem per prerje tubosh me diameter deri ne minimalisht 40mm.

77 Sharre druri

Sharra te jete e pershtatshme perprerjen e druve, me te pakten 70 dhembe per inch. Doreza te jete plastike me dy komponente per perdorim sa me te rehatshem. Te shoqerohet me kllëfin per mbulimin e tehut.

78 Çekiç hekuri i vogel

Cekici te jete I prodhuar nga celik I temperuar me bisht solid te mbuluar me fibra xhami me fuksion reduktues te vibrimeve.

79 Dalte

Dalte celiku me maje. Gjatesia te pakten 250mm.

80 Syze mbrojtese

Syze mbrojtese me gjatesi bishti te ndryshueshme. Te jene me mbulese per pjesen anesore te syve.

81 Litar sigurie

Litari i sigurise te jete materjal poliester me 4 pika rregullimi gjatesie dhe 1 pike per lidhjen e litarit te sigurise. Te jete e kompletuar me litar sigurie me diameter minimalisht 12mm dhe gjatesi te pakten 1.5m

82 Maske kundragazit me ndricim

Maske kundergazit profesionale me valvul dhe me karbonm. Te shoqerohet me elektrik koke me drite LED me te pakten dy shkalle ndricimi, 100 dhe 200 lumen. .

83 Ndricules Led te vegjel

Ndricules led me fluks ndriimi te pakten 2500 lumen. Permasat most e jene me shume se 210x140mm. Temperatura e ndricimit6500K.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1				
2				
3.				

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; perkatësisht **114.983 (njqind e katermbdhjete mije e nenteqind e tetedhjte e tre***

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2024)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.)

2.2.3.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

2.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi. Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen. Në rast se katalogjet janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none">Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

⁶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

